

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E MBROJTJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **217-26-4254-1-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizimi me veshmbathje pune dhe servise për automjete (SUFKS 1001) për nevoja e FSK-se.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

PROGLOBAL SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Dardani, Rr. 28 Nentori, LI-2, Lok 129

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

044148645

(Numri Telefonit)

Latif Imeri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@proglobal-ks.com

(Adresa elektronike)

28.09.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- | | |
|---------------------------------------|--------------|
| ○ Njoftimi për kontrate | – 08.06.2026 |
| ○ Kërkesa për sqarime të TD | - 01.07.2026 |
| ○ Sqarimi i TD | - 15.07.2026 |
| ○ Hapja e ofertave | – 06.08.2026 |
| ○ Njoftimi mbi vendimin e AK-se | – 07.09.2026 |
| ○ Kërkesa për Rishqyrtim | – 14.09.2026 |
| ○ Vendimi i Ak-se Refuzimi i kërkesës | - 18.09.2026 |
| ○ Ankesa OSHP | - 28.09.2026 |

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

- Hapja e ofertave – 06.08.2026

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐

Jo ☐

Operatori Ekonomik ankues “Proglobal” shpk – Prishtine, me daen 14.09.2026, ka paraqitur kerkese për ri shqyrtim kundër vendimit te AK- MM, janë paraqit prova dhe dëshmi lidhur me shkeljet ligjore por qe AK – MM, nuk jep pergjigje te mirefillt dhe le ne fuqi vendmin e saje ani pse te kunderligjeshem.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Shkeljet ligjore te LPP-se nr. 04/L-042.

Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtim / mosdiskriminimi

Neni 24 i Rregullores Nr. 001/2022 – Sqarimet e Dosjes së Tenderit

Neni 59, paragrafi 4 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve

Neni 60 – Kriteret për Dhënien e Kontratës

Rregullorja për Prokurim Publik, 001/2022

Neni 17 Dosja e tenderit

Neni 40 – Ekzaminimi vlereismi dhe krahasimi i ofertave

Neni 97 Shkeljet e renda.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Fillimisht, sqarojme se me datë 14.09.2026, Operatori Ekonomik ankues ka ushtruar brenda afatit ligjor kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues - Ministria e Mbrojtjes duke ngritur gjithësej 23, pretendime ankimore konkrete, të mbështetura në specifikime teknike të detyrueshme dhe të percaktuara në DT, në sqarimet e publikuara në platformën e-prokurimi, katalogë dhe mostrat fizike, por cuditërisht Autoriteti Kontraktues po të njëjtën ditë më 18.09.2026 ka nxjerrë Vendimin me nr. Prot. 5115, i cili paraqet një akt administrativ krejtësisht shabllon pa asnjë arsyetim ligjor dhe si rrjedhojë e kesaje dhe me këtë veprim AK ka shkelur rëndë dispozitat e nenit 108/A të LPP-së, i cili e detyron Autoritetin Kontraktues që të shqyrtoj në mënyrë meritore dhe objektive secilin pretendim.

Pra diferencat e matshme numerike të dendësisë së materialit, mospërputhjet thelbësore të përbërjes së tekstilit, apo mosplotësimi i kërkesave për Celik Inox 316L, AK nuk i ka trajtuar fare, prandaj në kuptim të nenit 109 të LPP-se me poshte po paraqesim kundër argumentet dhe bazen ligjore sime poshte:

Pretendimet ankimore, për – OE PROGLOBAL SHPK

Pretendimi ankimor 1

Në Letrën Standarde të dërguar kundrejt OE PROGLOBAL SH.P.K., Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar refuzimin për pozicionin Nr. 1 si në vijim:

- *“Në Aneksin 1 kërkohet që materiali të jetë që thitë lagështinë dhe ofron ajrosje optimale për të mbajtur këmbët e thata. Mostra e ofruar, materiali komplet lëkurë, i cili nuk lejon ajrosje optimale për të mbajtur këmbët e thata dhe të freskëta.”*

Ky konstatim i Autoritetit Kontraktues NUK qëndron dhe NUK është i mbështetur në karakteristikat teknike të produktit konkret të ofertuar, pasi që OE PROGLOBAL SH.P.K. ka ofertuar dhe ka dorëzuar **mostër modelin VIRGINIA** të prodhuesit Italian EXENA, **së bashku me dokumentacionin teknik përkatës të produktit**. Produkti i ofertuar nuk mund të konsiderohet si teknikisht i papërshtatshëm vetëm për faktin se pjesa e sipërme e këpucës është e prodhuar nga lëkura. Materiali i jashtëm prej lëkure, në vetvete, nuk përbën provë se një këpucë profesionale nuk mund të ofrojë frymëmarrje, menaxhim të lagështisë dhe ajrosje të këmbës. Këto karakteristika varen nga konstruksioni i përgjithshëm i këpucës, materialet e brendshme, astari dhe teknologjia e përdorur nga prodhuesi.

Për më tepër, në dokumentacionin teknik të produktit të ofertuar paraqitet edhe simboli përkatës:



- Simboli i frymëmarrjes / ventilimit

Ky simbol identifikon karakteristikën e frymëmarrjes/ventilimit (breathability/ventilation) të këpucës dhe përbën dëshmi teknike relevante që duhet të merret në konsideratë së bashku me specifikimet dhe dokumentacionin e prodhuesit gjatë vlerësimit të ofertës.

Prova – Ne shuallin e kepuces mbishkrimi *ABSORBER*

exena.

VIRGINIA (A0211V049)

S3 FO SR



Line

Work

Protection class

S3 FO SR

Norm

EN ISO 20345:2022+A1:2024

Intended use

Constructions, Gardening and farming, Industry and workshop, Logistic, Plant engineering

Technologies

C-Dry, X-Mesh, Steel, Lamina Steel, 2d

Certificates



25/06/2026

UPPER

Printed leather, water-repellent treatment

LINING

Breathable, abrasion resistant textile

SAFETY TOE CAP

Steel 200j

PIERCE RESISTANCE

Stainless steel

FOOTBED

Removable, cushioned, antistatic

OUTSOLE

PU 2D antislip SR

SIZE RANGE

35-48

Utilizziamo i cookie per essere sicuri che tu possa avere la migliore esperienza sul nostro sito. Se continui ad utilizzare questo sito noi assumiamo che tu ne sia felice.

Ok No Privacy policy

Rrjedhimisht, konstatimi i AK-së se “materiali komplet lëkurë nuk lejon ajrosje optimale” është një konkluzion i përgjithësuar mbi llojin e materialit dhe jo një vlerësim teknik i karakteristikave të modelit konkret EXENA VIRGINIA të ofertuar.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se produkti nuk e përmbush kërkesën për thithjen e lagështisë dhe ajrosjen optimale, atëherë një konstatim i tillë duhet të mbështetet në dokumentacion teknik, rezultat testimi, standard, specifikim të prodhuesit ose provë tjetër objektive, e cila demonstroi se modeli konkret i ofertuar nuk e posedon këtë karakteristikë. Vetëm konstatimi vizual se mostra është prej lëkure nuk është i mjaftueshëm për të dëshmuar mungesën e frymëmarrjes apo ventilimit të produktit nuk prejudikon.

Përkundrazi, **PROGLOBAL SH.P.K. ka paraqitur produktin konkret, dokumentacionin teknik të tij dhe mostrën fizike, nga të cilat mund të verifikohen karakteristikat e produktit dhe përputhshmëria e tij me kërkesat e Aneksit 1 të DT, përfshi materialin me veti të thithjes së lagështinë dhe që ofron ajrosje optimale për të mbajtur këmbët e thata.**

Gjithashtu, produkti i ofertuar është paraqitur me dokumentacionin përkatës të përputhshmërisë me **standardet CE/EN ISO të aplikueshme për këpucët profesionale të sigurisë**, gjë që duhet të vlerësohet në tërësi dhe jo të anashkalohet duke u bazuar vetëm në konstatimin vizuel se materiali i jashtëm është prej lëkure.

Për këto arsye, konsiderojmë se eliminimi i ofertës së PROGLOBAL SH.P.K. për Pozicionin Nr. 1, NUK është i pabazuar, pasi AK nuk ka dëshmuar teknikisht se modeli i kepuceve EXENA VIRGINIA - Italy nuk e përmbush kërkesën për ajrosje optimale dhe mbajtjen e këmbëve të thata dhe të freskëta.

Për më tepër, një vlerësim i tillë është në kundërshtim me parimin e ekzaminimit dhe vlerësimit objektiv të tenderëve dhe me nenin 59 të LPP-së, pasi përputhshmëria duhet të përcaktohet duke u bazuar në kërkesat konkrete të DT-së dhe në dokumentacionin/dëshmitë teknike të produktit të ofertuar, e jo në supozimin se një këpucë me pjesë të sipërme prej lëkure automatikisht nuk mund të jetë e ajroshme.

Prandaj kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që gjatë rishqyrtimit të vendimit të riezaminojë dokumentacionin teknik dhe mostrën e modelit EXENA VIRGINIA, përfshirë karakteristikën e deklaruar të frymëmarrjes/ventilimit, dhe të anulojë këtë arsye të eliminimit si të pabazuar.

Prova 1 – Catalogu i prodhuesit me EU Certifikaten e Konformitetit

Pretendimi ankimor 2

Në Letrën Standarde drejtuar kompanise sone OE PROGLOBAL SH.P.K., Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar eliminimin për pozicionin Nr. 2 si në vijim:

- *“Kërkohen pantallona të cilët kanë zonë të përforcuar tek gjunjët për rezistencë dhe jetëgjatësi më të madhe gjatë punës në pozicione të ulëta ose në gjunjë. Mostra e ofruar nuk ka zonë të përforcuar tek gjunjët.”*

Ky arsyetim NUK qëndron dhe është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me sqarimin zyrtar të dhënë paraprakisht nga vetë Autoriteti Kontraktues gjatë procedurës së tenderimit.

Në specifikimet teknike për pantallonat ishte përcaktuar:

“Zona të përforcuara në gjunjë për rezistencë dhe jetëgjatësi më të madhe gjatë punës në pozicione të ulëta ose në gjunjë.”

Gjithashtu ishte paraparë:

“Mundësi për vendosjen e mbrojtëseve të gjunjëve (knee pads), sipas nevojës (opsionale).”

Pikërisht për të shmangur çdo paqartësi lidhur me interpretimin e kësaj kërkesë, gjatë fazës së sqarimeve është kërkuar nga AK të konfirmojë nëse mund të ofrohen mbrojtëse të jashtme të gjunjëve, të cilat vendosen mbi pantallona dhe e realizojnë funksionin e mbrojtjes së zonës së gjurit.

Në përgjigjen zyrtare, Autoriteti Kontraktues ka deklaruar shprehimisht:

“Autoriteti Kontraktues konfirmon se interpretimi i paraqitur nga operatori ekonomik është i saktë. Në rast se ofrohen mbrojtëse të gjunjëve të jashtme, nuk është e nevojshme që pantallonat të kenë xhepa të brendshëm për vendosjen e mbrojtëseve apo përforcime në pjesën e gjunjëve, pasi funksioni i mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë sigurohet nga vetë mbrojtëset e jashtme. Për rrjedhojë, oferta e tillë do të konsiderohet në përputhje me kërkesat e Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit.”

Ky sqarim është i qartë, konkret. AK ka konfirmuar se, kur ofrohen mbrojtëse të jashtme të gjunjëve: nuk është e nevojshme që pantallonat të kenë përforcime në pjesën e gjunjëve, sepse funksioni i mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë realizohet nga mbrojtëset e jashtme.

PROGLOBAL SH.P.K. e ka përgatitur ofertën duke u bazuar pikërisht në këtë sqarim zyrtar të Autoritetit Kontraktues dhe ka ofertuar zgjidhjen teknike të lejuar nga AK.

Për këtë arsye është kontradiktore dhe e pabazuar që i njëjti Autoritet Kontraktues, gjatë fazës së vlerësimit, ta eliminojë PROGLOBAL SH.P.K. me arsyetimin se:

“Mostra e ofruar nuk ka zonë të përforcuar tek gjunjët”,

kur para dorëzimit të ofertave AK kishte konfirmuar shprehimisht se në rast të ofrimit të mbrojtëseve të jashtme “nuk është e nevojshme që pantallonat të kenë përforcime në pjesën e gjunjëve” dhe se një ofertë e tillë “do të konsiderohet në përputhje me kërkesat e Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit.”

Në këtë mënyrë, AK gjatë vlerësimit praktikisht ka aplikuar një interpretim të kërkesës teknike të kundërt me interpretimin që vetë AK ua ka komunikuar operatorëve ekonomikë gjatë fazës së sqarimeve.

Një veprim i tillë cenon parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe sigurisë juridike të procedurës, pasi operatorët ekonomikë duhet të kenë të drejtë të mbështeten në sqarimet zyrtare të publikuara nga Autoriteti Kontraktues gjatë përgatitjes së ofertave të tyre.

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një interpretim subjektiv të PROGLOBAL SH.P.K., por me një mënyrë përmbushjeje të kërkesës që është paraqitur për sqarim dhe është pranuar shprehimisht nga AK para dorëzimit të ofertave.

Prandaj, arsyeja e eliminimit për pozicionin nr. 2 është në kundërshtim me dokumentacionin e vetë procedurës së prokurimit dhe me sqarimin zyrtar të Autoritetit Kontraktues.

Prova: Kërkesa për sqarim e OE dhe përgjigjja zyrtare e Autoritetit Kontraktues, ku konfirmohet se, në rast të ofrimit të mbrojtëseve të jashtme të gjunjëve, nuk kërkohet që pantallonat të kenë përforcime në pjesën e gjunjëve dhe se oferta e tillë konsiderohet në përputhje me Aneksin 1.

- Zona të përforcuara në gjunjë për rezistencë dhe jetëgjatësi më të madhe gjatë punës në pozicione të ulëta ose në gjunjë.
- Mundësi për vendosjen e mbrojtëseve të gjunjëve (knee pads), sipas nevojës. (opsionale)

Nga aspekti teknik dhe praktik, jetëgjatësia e pantallonave është dukshëm më e madhe kur përdoren mbrojtëse të gjunjëve që vendosen mbi pantolla, pasi ato mbrojnë drejtpërdrejt pjesën e jashtme të gjurit nga konsumimi, fërkimi dhe

Përgjigjja

Autoriteti Kontraktues konfirmon se interpretimi i paraqitur nga operatori ekonomik është i saktë. Në rast se ofertohen mbrojtëse të gjunjëve të jashtme, nuk është nevojshme që pantallonat të kenë xhepa të brendshëm për vendosjen e mbrojtëseve apo përf forcime në pjesën e gjunjëve, pasi funksioni i mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë sigurohet nga vetë mbrojtëset e jashtme. Për rrjedhojë, oferta e tillë do të konsiderohet në përputhje me kërkesat e Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit.

Prova 2 - Sqarimet e AK

Pretendimi ankimor 3

Në Letrën Standarde drejtuar kompanise sonë OE PROGLOBAL SH.P.K., Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar refuzimin për Pozicionin Nr. 8 si në vijim:

- *“Kërkohen dorëza të cilat kanë shtresa të përforcuara në pjesën e pëllëmbës dhe gishtave për rezistencë më të lartë ndaj konsumimit dhe fërkimit. Mostra e ofruar nuk ka shtresë të përforcuar në gishta dhe në pëllëmbë.”*

Ky konstatim i Autoritetit Kontraktues NUK qëndron dhe nuk përputhet me dokumentacionin teknik dhe mostrën fizike të produktit të ofertuar nga PROGLOBAL SH.P.K.

Për Pozicionin nr. 8, **PROGLOBAL SH.P.K. ka dorëzuar së bashku me ofertën dokumentacionin teknik/katalogun e produktit, EU Declaration of Conformity, si dhe mostrën fizike të dorëzës së ofertuar.**

Nga dokumentacioni teknik i produktit dhe nga ekzaminimi i mostrës fizike mund të konstatohet lehtësisht se dorëzat e ofertuar posedojnë shtresa/zona të përforcuara në pjesën e pëllëmbës dhe gishtave, të destinuara për rritjen e rezistencës gjatë përdorimit, përfshirë rezistencën ndaj konsumimit dhe fërkimit.

Edhe vetë konstrukti i mostrës së dorëzuar paraqet qartë dallimin ndërmjet materialeve dhe zonave funksionale të dorëzës. Në pjesën e pëllëmbës dhe në pjesë të gishtave janë të dukshme zona/materiale të ndryshme nga materiali bazë i pjesës së sipërme të dorëzës, të cilat përbëjnë pjesë të konstruksionit mbrojtës të produktit.

Prova 3 - Dorezat, pjese e ofertes



Për rrjedhojë, konstatimi i AK-së se “mostra e ofruar nuk ka shtresë të përforcuar në gishta dhe në pëllëmbë” është në kundërshtim me karakteristikat e produktit të ofertuar dhe me dokumentacionin teknik të dorëzuar në ofertë.

Gjithashtu, **EU Declaration of Conformity dhe dokumentacioni përkatës i produktit, perfshi mostren**, duhet të shqyrtohen në tërësi për të përcaktuar karakteristikat dhe përputhshmërinë e produktit me standardet relevante të deklaruara nga prodhuesi.

Nëse Autoriteti Kontraktues ka konsideruar se zonat/materialet e pranishme në pëllëmbë dhe gishta nuk përbëjnë “shtresa të përforcuara” sipas kërkesës së Aneksit 1, atëherë AK duhet të argumentojë mbi çfarë prove teknike dhe mbi cilin kriter objektiv ka arritur në këtë përfundim, veçanërisht kur dokumentacioni teknik i produktit të ofertuar dhe mostra dëshmon të kundërtën.

Në këtë mënyrë, konsiderojmë se **AK NUK ka bërë ekzaminim të plotë dhe objektiv të dëshmive të dorëzuara me ofertën**, duke arritur në një konstatim që kundërshtohet nga katalogu teknik dhe nga karakteristikat e produktit konkret të paraqitur si mostër.

Për rrjedhojë, arsyeja e eliminimit për Pozicionin Nr. 8 është e pabazuar dhe faktikisht e pasaktë, ndërsa eliminimi i PROGLOBAL SH.P.K. mbi këtë bazë nuk është në përputhje me mënyrën e ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve të përcaktuar me nenin 59 të LPP-së.

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që në procedurën e rishqyrtimit të bëjë riekzaminimin e Pozicionit Nr. 8, duke shqyrtuar së bashku:

Mostrën fizike + katalogun/dokumentacionin teknik + EU Declaration of Conformity, dhe të konstatojë se dorëzat e ofertuar posedojnë përforcimet e kërkuara në zonën e pëllëmbës dhe gishtave dhe, rrjedhimisht, ta anulojë këtë arsye të eliminimit si të pabazuar.

Prova 3 - Katalogu/dokumentacioni teknik i dorëzuar me ofertën; EU Declaration of Conformity e Pozicionit Nr. 8 dhe fotografia e produktit të ofertuar.

Pretendimet ankimore kundër OE NAIM SHUKI B.I.

Pretendimi ankimor 4

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, për artikullin “Syze Mbrojtëse për Mekanik”, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar ndër të tjera këto kërkesa:

“Trajtim anti-mjegull (anti-fog) për pamje të qartë gjatë përdorimit në ambiente me ndryshim temperature ose lagështi” dhe “Ruajtje në kuti ose mbështjellës mbrojtës për shmangien e gërvishtjeve dhe dëmtimeve.”

Nga shqyrtimi i ofertës teknike dhe mostrës së dorëzuar nga OE **Naim Shuki B.I.**, i propozuar për dhënie të kontratës, konstatohet se syzet mbrojtëse të ofertuar nuk dëshmojnë përmbushjen e këtyre dy kërkesave të detyrueshme teknike.

Konkretisht, për syzet e ofertuara nuk është dëshmuar se lentet posedojnë trajtim anti-mjegull (anti-fog). Në dokumentacionin teknik të paraqitur për produktin nuk rezulton karakteristika e kërkuar anti-fog, ndërsa as nga mostra e dorëzuar nuk ekziston etiketim apo dëshmi përmes së cilës mund të verifikohet se syzet e ofertuar posedojnë këtë trajtim.

Kjo nuk është një karakteristikë e parëndësishme apo estetike. **Autoriteti Kontraktues e ka kërkuar shprehimisht trajtimin anti-fog** për të siguruar pamje të qartë gjatë përdorimit në ambiente me ndryshim temperature ose lagështi dhe, rrjedhimisht, përbën karakteristike funksionale të produktit të kërkuar.

Gjithashtu, **mostra e syzeve të dorëzuara nga OE i propozuar për kontratë nuk është pajisur me kuti apo mbështjellës mbrojtës**, ndonëse në Aneksi 1 është kërkuar shprehimisht “Kuti ose Mbështjellës mbrojtës për shmangien e gërvishtjeve dhe dëmtimeve.”

Pra, për të njëjtin artikull janë dy mospërputhje konkrete me Aneksin 1:

1. Mungesa/mosdëshmimi i trajtimit anti-mjegull (anti-fog);
2. Mungesa e kutisë ose mbështjellësit mbrojtës të kërkuar.

Përderisa këto karakteristika janë përcaktuar në SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, ato nuk mund të konsiderohen fakultative dhe as të supozohet se OE do t'i sigurojë pas dhënies së kontratës, nëse produkti konkret i ofertuar dhe mostra e dorëzuar nuk dëshmojnë përmbushjen e tyre.

Nëse AK e ka konsideruar këtë artikull teknikisht të pranueshëm, kërkojmë të sqarohet mbi cilën dëshmi teknike është konstatuar se syzet posedojnë trajtim anti-fog dhe ku është konstatuar ekzistenca e kutisë ose mbështjellësit mbrojtës, kur këto elemente nuk rezultojnë nga oferta/mostra e dorëzuar.

Kjo është veçanërisht relevante në raport me mënyrën se si është vlerësuar oferta e PROGLOBAL SH.P.K., ku AK ka përdorur karakteristika të mostrave si bazë për eliminim, ndërsa për OE të rekomanduar për kontratë ka konsideruar të pranueshëm një produkt që, sipas dokumentacionit dhe mostrës së dorëzuar, nuk dëshmon karakteristika të kërkuara shprehimisht në Aneksin 1.

Një trajtim i tillë ngre çështje serioze në raport me Nenin 7 të LPP-së – barazia në trajtim dhe mosdiskriminimi, si dhe me Nenin 59, veçanërisht paragrafin 4 të LPP-së, lidhur me ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që gjatë rishqyrtimit të vendimit të bëjë riekzaminimin e ofertës teknike dhe mostrës së syzeve mbrojtëse të OE Naim Shuki B.I., Sipas dëshmimeve artikulli i ofertuar nuk është në përputhje me Specifikimet Teknike të Detyrueshme të Aneksit 1.

Pretendimi ankimor 5

Në Aneksin 1 – “SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME”, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht kërkesën si në vijim:

“OE duhet të ofroj të dhënat mbi emrin e prodhuesit si dhe vendin e origjinës të produktit që oferton, si dhe specifikimet teknike sipas katalogut – broshurës (shëno numrin e faqes në katalog apo broshurë).”

Nga shqyrtimi i ofertës së Operatorit Ekonomik Naim Shuki B.I., konstatohet se në tabelën përkatëse OE ka plotësuar vetëm emrin e prodhuesit, ndërsa nuk ka ofruar të gjitha të dhënat e tjera të kërkuara shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues.

Konkretisht, OE nuk ka plotësuar:

1. Vendin e origjinës së produktit të ofertuar;
2. Specifikimet teknike sipas katalogut/broshurës dhe referencën përkatëse të faqes në katalog apo broshurë, ashtu siç është kërkuar në Aneksin 1.

Kjo kërkesë **nuk është paraqitur si informacion opsional, por është përfshirë në Aneksin 1** të emërtuar “SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME”, dhe **formulimi “OE duhet të ofroj”** përcakton qartë obligimin e secilit operator ekonomik për plotësimin e këtyre të dhënave.

Mosplotësimi i këtyre elementeve e bën të pamundur verifikimin e ofertës teknike në mënyrën e përcaktuar paraprakisht nga vetë Autoriteti Kontraktues, përkatësisht identifikimin e origjinës së produktit dhe lidhjen e karakteristikave të deklaruara me faqen konkrete të dokumentacionit teknik të prodhuesit.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se **oferta e OE Naim Shuki B.I. NUK është në përputhje të plotë me kërkesat e detyrueshme të Dosjes së Tenderit dhe Aneksit 1.**

Autoriteti Kontraktues nuk mund të aplikojë standarde të ndryshme gjatë vlerësimit të ofertave dhe as të konsiderojë si të përmbushur një kërkesë të cilën vetë e kapërcaktuar si të detyrueshme, kur operatori ekonomik NUK ka paraqitur të dhënat e kërkuara në ofertën e tij.

Prandaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që gjatë rishqyrtimit të vendimit të bëjë rivlerësimin e ofertës së OE Naim Shuki B.I. në raport me kërkesat e detyrueshme të Aneksit 1, dhe të konstatojë mosplotësimin e kërkesave të sipërpërmendura.

Pretendimi ankimor 6

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar si kërkesë për artikujt e veshjeve:

“Certifikim përputhshmërie me standardet relevante EN ISO / CE për veshje pune profesionale.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së OE Naim Shuki B.I., i propozuar për dhënie të kontratës, konstatohet se për artikujt e veshjeve pjesë e ofertës nuk janë dorëzuar certifikatat/dokumentet e përputhshmërisë EN ISO / CE të kërkuara në Aneksin 1.

Kërkesa për certifikim është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në kuadër të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme dhe për këtë arsye përmbushja e saj duhet të vlerësohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Në mungesë të dokumentacionit të kërkuar të përputhshmërisë, nuk mund të konsiderohet e dëshmuar se artikujt e veshjeve të ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë janë në përputhje me standardet relevante EN ISO dhe kërkesat CE të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues nuk duhet ta konsiderojë të përmbushur një kërkesë teknike të detyrueshme vetëm mbi bazën e deklaratimit të OE-së, kur Dosja e Tenderit ka kërkuar shprehimisht certifikim të përputhshmërisë.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që gjatë rishqyrtimit të vendimit të verifikojë për secilin artikull të veshjeve në ofertën e OE Naim Shuki B.I. ekzistencën e dokumentacionit të kërkuar EN ISO / CE dhe, dhe meqenese ky dokumentacion nuk është dorëzuar sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, të konstatojë se oferta NUK i përmbush kërkesat e detyrueshme teknike të Aneksit 1 dhe të ndërmarrë veprimet përkatëse në përputhje me dispozitat e prokurimit publik.

Pretendimi ankimor 7

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht kërkesën:

“Të gjitha artikujt duhet të jenë të disponueshëm në madhësitë standarde: Për veshje: S, M, L, XL, 2XL, 3XL.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të ofertës së OE Naim Shuki B.I., i propozuar për dhënie të kontratës, konstatohet se nuk është paraqitur asnjë dokument teknik, katalog, broshurë apo dokument tjetër i prodhuesit nga i cili mund të verifikohet se artikujt e veshjeve të ofertuar janë të disponueshëm në të gjitha madhësitë e kërkuara S, M, L, XL, 2XL dhe 3XL.

Kërkesa për disponueshmërinë e artikujve në këto madhësi është përcaktuar në kuadër të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme dhe përbën pjesë të kërkesave teknike që produktet e ofertuar duhet t'i përmbushin.

Përderisa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka paraqitur dokumentacion nga i cili mund të vërtetohet disponueshmëria e produkteve të ofertuar në të gjitha madhësitë e kërkuara, NUK ekziston bazë dokumentare në ofertën e dorëzuar që i mundëson Autoritetit Kontraktues të konstatojë përmbushjen e kësaj kërkesë teknike.

Kjo mangësi bëhet edhe më relevante duke marrë parasysh se në të njëjtin Aneks 1, **Autoriteti Kontraktues ka kërkuar nga OE që të paraqesë specifikimet teknike sipas katalogut/broshurës dhe të shënojë numrin e faqes përkatëse**, pikërisht me qëllim që karakteristikat e produkteve të ofertuar të jenë të identifikueshme dhe të verifikueshme.

Rrjedhimisht, një deklaram i përgjithshëm apo supozim se artikujt mund të furnizohen në madhësitë e kërkuara nuk mund të zëvendësojë dokumentacionin teknik të ofertës, nëse përmbushja e kësaj kërkesë nuk rezulton nga dokumentet e paraqitura me ofertë.

Për këtë arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që gjatë rishqyrtimit të vendimit të vertetojë se dokumentacioni i dorëzuar brenda ofertës nga OE Naim Shuki B.I. NUK ka dëshmuar se artikujt e ofertuar janë të disponueshëm në madhësitë S, M, L, XL, 2XL dhe 3XL dhe, në mungesë të një dëshmie të tillë, të konstatojë se oferta NUK dëshmon përmbushjen e kërkesave të detyrueshme teknike të Aneksit 1.

Pretendimi ankimor 8

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht kërkesën:

“Të gjitha produktet duhet të përmbajnë etiketa origjinale të prodhuesit, përfshirë udhëzimet për përdorim, mirëmbajtje, kushtet e larjes dhe ruajtjes sipas standardeve të produktit.”

Nga ekzaminimi i mostrave të veshjeve të dorëzuara nga OE Naim Shuki B.I., i propozuar për dhënie të kontratës, konstatohet **se mostrat e dorëzuara nuk dëshmojnë përmbushjen e kërkesës së mësipërme të detyrueshme.**







Konkretisht, në mostrat e dorëzuara mungojnë etiketimet dhe informacionet e kërkuara në Dosjen e Tenderit, përkatësisht:

- mungon etiketimi/referenca për standardin relevant EN të produktit;
- mungojnë udhëzimet për përdorim;
- mungojnë informacionet/udhëzimet për mirëmbajtje;
- mungojnë kushtet dhe udhëzimet për larje;
- mungojnë udhëzimet/kushtet për ruajtjen e produktit sipas standardeve relevante të produktit.

Këto elemente janë kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues. Përkundrazi, ato janë vendosur në kuadër të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme, ndërsa mostrat e dorëzuara kanë pasur pikërisht qëllimin që Autoritetit Kontraktues t'i mundësojnë verifikimin fizik të përputhshmërisë së artikujve të ofertuar me kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Në këtë rast kemi të bëjmë me një mospërputhje që mund të konstatohet drejtpërdrejt nga vetë mostrat fizike të dorëzuara. Nëse etiketa origjinale dhe informacionet e kërkuara nuk gjenden në mostrat e paraqitura brenda afatit të tenderimit, atëherë përmbushja e kësaj kërkesë NUK është dëshmuar nga produkti i ofertuar dhe mostra e dorëzuar për vlerësim.

Veçanërisht duhet të merret parasysh se **kërkesa e AK-së përdor formulimin “Të gjitha produktet duhet të përmbajnë”**, që nënkupton se këto informacione duhet të jenë pjesë e produktit dhe etiketimit origjinal të tij dhe jo vetëm të deklarohen nga OE pa u reflektuar në produktin/mostrën e dorëzuar.

Për më tepër, kjo mangësi lidhet drejtpërdrejt edhe me kërkesën tjetër të Aneksit 1 për certifikimin e përputhshmërisë me standardet relevante EN ISO / CE për veshje pune profesionale. Mungesa e etiketimit të standardit relevant EN në mostrat e dorëzuara, së bashku me mungesën e dokumentacionit përkatës të certifikimit në ofertë, krijon mungesë

të dëshmisë së verifikueshme se produktet konkrete të ofertuar përmbushin kërkesat teknike të përcaktuara nga AK.

Nëse këto elemente nuk janë të pranishme në mostrat e dorëzuara, ashtu siç rezulton nga ekzaminimi i tyre, duhet të konstatohet se mostrat dhe rrjedhimisht oferta e OE Naim Shuki B.I. NUK dëshmojnë përmbushjen e kërkesave të detyrueshme teknike të Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit.

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar kërkesën për ngjyrën e artikujve si në vijim:
“Ngjyra: Gri, e zezë ose sipas kërkesës së autoritetit kontraktues.”

Nga ekzaminimi i mostrave të dorëzuara nga OE Naim Shuki B.I., i propozuar për dhënie të kontratës, konstatohet **se artikujt e paraqitur si mostra nuk janë ofruar vetëm në ngjyrën gri apo të zezë, por janë paraqitur në kombinim të tri ngjyrave: kaltër, gri dhe e zezë.**

Formulimi i Aneksit 1 përcakton si ngjyra të pranueshme gri ose të zezë, ndërsa alternativa “ose sipas kërkesës së autoritetit kontraktues” nuk mund të interpretohet si autorizim që OE të zgjedhë sipas dëshirës një ngjyrë apo kombinim tjetër ngjyrash.

Nëse Autoriteti Kontraktues nuk ka nxjerrë paraprakisht ndonjë kërkesë, sqarim apo përcaktim me të cilin është kërkuar ose lejuar ngjyra e kaltër apo kombinimi kaltër–gri–e zezë, atëherë mostra e dorëzuar nga OE nuk korrespondon me specifikimin teknik të përcaktuar në Aneksin 1.

Mostrat janë dorëzuar me qëllim të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve konkrete të ofertuar me kërkesat teknike të Dosjes së Tenderit. Për këtë arsye, vlerësimi duhet të bëhet mbi karakteristikat faktike të mostrës së dorëzuar dhe jo mbi mundësinë që produkti eventualisht të prodhohet ose të dorëzohet më vonë në një ngjyrë tjetër.

Pranimi i një mostre me konfigurim të ndryshëm nga specifikimi i përcaktuar në Aneksin 1, pa ekzistuar një kërkesë apo autorizim paraprak i AK-së për këtë konfigurim, do të nënkuptonte pranimin e një karakteristike teknike që NUK është përcaktuar në kushtet e tenderit.

Për këtë arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që gjatë rishqyrtimit të vendimit të bëjë riekzaminimin e mostrave të dorëzuara nga OE Naim Shuki B.I., të konstatojë ngjyrat faktike të tyre.

Në mungesë të një kërkesë apo miratimi paraprak të AK-së për kombinimin e paraqitur, konsiderojmë se mostra e dorëzuar NUK dëshmon përputhshmëri të plotë me specifikimet teknike të detyrueshme të Aneksit 1.

Pretendimi ankimor 9

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, për artikullin “Dorëza speciale për telë gjemborë”, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht që materiali i dorezës të jetë:

“Çelik inox 316L.”

Kjo kërkesë është përcaktuar në mënyrë konkrete dhe nuk i referohet në përgjithësi vetëm materialit “çelik inox”, por një grade specifike të çelikut inox – 316L, e kërkuar për shkak të karakteristikave të tij, përfshirë rezistencën e lartë ndaj korrozionit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të dorëzuar nga OE i propozuar për dhënie të kontratës, konstatohet se për produktin e ofertuar materiali është deklaruar vetëm si:

“Stainless Steel / Çelik inox”, pa u specifikuar dhe pa u dëshmuar se bëhet fjalë konkretisht për çelik inox 316L, ashtu siç është kërkuar në Aneksin 1.

Termi i përgjithshëm “çelik inox” nuk është i barasvlershëm me specifikimin “çelik inox 316L”, pasi ekzistojnë grade të ndryshme të çelikut inox me përbërje dhe karakteristika të ndryshme. Për rrjedhojë, vetëm deklarimi se produkti është prej çeliku inox nuk është dëshmi se ai është prodhuar nga grada specifike 316L e kërkuar nga AK.

Katalogu, fleta teknike, deklarata e prodhuesit apo dokumentacioni tjetër i dorëzuar me ofertën NUK e identifikon materialin si specifikimin “çelik inox 316L”, atëherë OE nuk ka dëshmuar përmbushjen e kësaj kërkesë teknike të Aneksit 1.

Për më tepër, kjo mangësi nuk duhet të plotësohet pas afatit të ofertimit duke paraqitur një produkt tjetër apo duke ndryshuar materialin e produktit të ofertuar, pasi grada e materialit përbën një karakteristikë teknike të produktit konkret.

Në mungesë të kësaj dëshmie, konsiderojmë se **OE i propozuar për kontratë NUK ka dëshmuar përputhshmërinë e produktit të ofertuar me kërkesën e detyrueshme “Çelik inox 316L” të Aneksit 1**, dhe oferta duhet të riekzaminohet në përputhje me Nenin 59 të LPP-së, duke respektuar gjithashtu parimin e trajtimit të barabartë sipas Nenit 7 të LPP-së.

Prova: Aneksi 1 i DT-së dhe dokumentacioni teknik/katalogu i OE-së së propozuar, ku materiali është deklaruar vetëm “Stainless Steel”, pa specifikimin 316L.

Ka dallim të rëndësishëm, sepse “çelik inox” është term i përgjithshëm, ndërsa “çelik inox 316L” është një klasë specifike e çelikut inox.

Çelik inox 316L ka përbërje dhe karakteristika të përcaktuara, veçanërisht përmban molibden, që i jep rezistencë shumë të mirë ndaj korrozionit, përfshirë në mjedise me lagështi, kripë dhe disa kimikate. Shkronja L do të thotë Low Carbon (përmbajtje e ulët karboni).

Prandaj bazuar në faktet e lartcekura, konsiderojmë se **oferta e OE Naim Shuki B.I. nuk është dëshmuar si e përgjegjshme ndaj kërkesave të detyrueshme të Dosjes së Tenderit**, ndërsa Autoriteti Kontraktues, duke e shpallur këtë ofertë të përgjegjshme dhe duke e rekomanduar OE për dhënie të kontratës, NUK ka bërë ekzaminimin dhe vlerësimin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe dispozitat përkatëse të LPP-së.

Për këtë arsye kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të anulojë vendimin për dhënie të kontratës, ta kthejë procedurën në fazën e rivlerësimit dhe të bëjë riekzaminimin e ofertës dhe mostrave të OE Naim Shuki B.I. në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat e Aneksit 1 dhe dispozitat e LPP-së.

Pretendimet ankimore kundër ofertës se OE AGRON COMMERCE shpk

Pretendimi ankimor 10.

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, për artikullin “Këpuce të punës për Mekanik”, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar shprehimisht:

“Shtresë e brendshme amortizuese që absorbon goditjet dhe zvogëlon presionin në shputa dhe nyje.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik dhe mostrës së dorëzuar nga OE AGRON COMMERCE SH.P.K., konstatohet se NUK është dëshmuar se këpuca e ofertuar posedon shtresën amortizuese me karakteristikat e kërkuara nga DT, përkatësisht aftësinë për absorbimin e goditjeve dhe zvogëlimin e presionit në shputa dhe nyje.

Në mostrën e dorëzuar nuk është evidentuar ndonjë shënim apo identifikim që dëshmon karakteristikën e pretenduar të absorbimit/amortizimit, ndërsa kjo karakteristikë duhet të jetë e verifikueshme edhe përmes dokumentacionit teknik të produktit.

Mostra dorezuar nga **Agron Commerce**
NUK ka veti absorbuese



Mostra dorezuar nga Proglobal
ME veti absorbuese



Prandaj, nëse modeli konkret i ofertuar nga AGRON COMMERCE nuk ka në dokumentacionin teknik, certifikatën/raportin e testimit apo shënjimin përkatës dëshmi që konfirmon absorbimin e energjisë/goditjeve, AK NUK mund ta prezumojë këtë karakteristikë vetëm nga pamja e këpucës.

Nga dokumentacioni Teknik i ofertuar dhe mostra e dorëzuar, modeli konkret i ofertuar NUK posedon realisht shtresë të brendshme amortizuese;

Në mungesë të këtyre dëshmive, konsiderojmë se **OE AGRON COMMERCE SH.P.K. NUK ka dëshmuar përputhshmërinë e këpucëve të ofertuar me kërkesën e detyrueshme të Aneksit 1.**

Nëse AK e ka konsideruar këtë produkt të përgjegjshëm pa ekzistuar dëshmi për karakteristikën e kërkuar, atëherë kjo duhet të shqyrtohet në raport me Nenin 59 të LPP-së, si dhe me Nenin 7 të LPP-së për trajtim të barabartë.

Pretendimi ankimor 11

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht kërkesën:

“Të gjitha artikujt duhet të jenë të disponueshëm në madhësitë standarde: Për veshje: S, M, L, XL, 2XL, 3XL.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të **ofertës së OE Agron Commerce**, konstatohet se **NUK është paraqitur asnjë dokument teknik, katalog, broshurë apo dokument tjetër** i prodhuesit nga i cili mund të verifikohet se artikujt e veshjeve të ofertuar janë të disponueshëm në të gjitha madhësitë e kërkuara S, M, L, XL, 2XL dhe 3XL.

Kërkesa për disponueshmërinë e artikujve në këto madhësi është përcaktuar në kuadër të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme dhe përbën pjesë të kërkesave teknike që produktet e ofertuar duhet t'i përmbushin.

Përderisa OE nuk ka paraqitur dokumentacion nga i cili mund të vërtetohet disponueshmëria e produkteve të ofertuar në të gjitha madhësitë e kërkuara, NUK ekziston bazë dokumentare në ofertën e dorëzuar që i mundëson Autoritetit Kontraktues të konstatojë përmbushjen e kësaj kërkesë teknike.

Kjo mangësi bëhet edhe më relevante duke marrë parasysh se në të njëjtin Aneks 1, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar nga OE që të paraqesë specifikimet teknike sipas katalogut/broshurës dhe të shënojë numrin e faqes përkatëse, pikërisht me qëllim që karakteristikat e produkteve të ofertuar të jenë të identifikueshme dhe të verifikueshme.

Rrjedhimisht, një deklaram i përgjithshëm apo supozim se artikujt mund të furnizohen në madhësitë e kërkuara NUK mund të zëvendësojë dokumentacionin teknik të ofertës, nëse përmbushja e kësaj kërkesë nuk rezulton nga dokumentet e paraqitura me ofertë.

Për këtë arsye, mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar brenda ofertës OE Agron Commerce NUK ka dëshmuar se artikujt e ofertuar janë të disponueshëm në madhësitë S, M, L, XL, 2XL dhe 3XL dhe, në mungesë të një dëshmie të tillë, oferta NUK dëshmon përmbushjen e kërkesave të detyrueshme teknike të Aneksit 1.

Pretendimi ankimor 12

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht kërkesën:

“Të gjitha produktet duhet të përmbajnë etiketa origjinale të prodhuesit, përfshirë udhëzimet për përdorim, mirëmbajtje, kushtet e larjes dhe ruajtjes sipas standardeve të produktit.”

Nga ekzaminimi i mostrave të veshjeve të dorëzuara nga **OE Agron Commerce**, konstatohet se mostrat e dorëzuara **nuk dëshmojnë përmbushjen e kërkesës së mësipërme të detyrueshme.**





Konkretisht, në mostrat e dorëzuara mungojnë etiketimet dhe informacionet e kërkuara në Dosjen e Tenderit, përkatësisht:

- mungon etiketimi/referenca për standardin relevant EN të produktit;
- mungojnë udhëzimet për përdorim;
- mungojnë informacionet/udhëzimet për mirëmbajtje;
- mungojnë kushtet dhe udhëzimet për larje;
- mungojnë udhëzimet/kushtet për ruajtjen e produktit sipas standardeve relevante të produktit.

Këto elemente janë kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues. Përkundrazi, ato janë vendosur në kuadër të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme, ndërsa mostrat e dorëzuara kanë pasur pikërisht qëllimin që Autoritetit Kontraktues t'i mundësojnë verifikimin fizik të përputhshmërisë së artikujve të ofertuar me kërkesat teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Në këtë rast **kemi të bëjmë me një mospërputhje që mund të konstatohet drejtpërdrejt nga vetë mostrat fizike të dorëzuara**. Nëse etiketa origjinale dhe informacionet e kërkuara NUK gjenden në mostrat e paraqitura brenda afatit të tenderimit, atëherë përmbushja e kësaj kërkesë NUK është dëshmuar nga produkti i ofertuar dhe mostra e dorëzuar për vlerësim.

Veçanërisht duhet të merret parasysh se **kërkesa e AK-së përdor formulimin “Të gjitha produktet duhet të përmbajnë”**, që nënkupton se këto informacione duhet të jenë pjesë e produktit dhe etiketimit origjinal të tij dhe jo vetëm të deklarohen nga OE pa u reflektuar në produktin/mostrën e dorëzuar.

Për më tepër, kjo mangësi lidhet drejtpërdrejt edhe me kërkesën tjetër të Aneksit 1 për certifikimin e përputhshmërisë me standardet relevante EN ISO / CE për veshje pune profesionale. **Mungesa e etiketimit të standardit relevant EN në mostrat e dorëzuara, së bashku me mungesën e dokumentacionit përkatës të certifikimit në ofertë, krijon mungesë të dëshmisë së verifikueshme** se produktet konkrete të ofertuar përmbushin kërkesat teknike të përcaktuara nga AK.

Meqenese **këto elemente NUK janë të pranishme në mostrat e dorëzuara**, ashtu siç rezulton nga ekzaminimi i tyre, duhet të konstatohet se mostrat dhe rrjedhimisht oferta e OE Agron Commerce NUK dëshmonë përmbushjen e kërkesave të detyrueshme teknike të Aneksit 1 të Dosjes së Tenderit.

Pretendimi ankimor 13

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, për artikullin “Syze Mbrojtëse për Mekanik”, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar ndër të tjera këto kërkesa:

- *“Trajtim anti-mjegull (anti-fog) për pamje të qartë gjatë përdorimit në ambiente me ndryshim temperature ose lagështi.” dhe “Ruajtje në kuti ose mbështjellës mbrojtës për shmangien e gërvishtjeve dhe dëmtimeve.”*

Nga shqyrtimi i ofertës teknike dhe mostrës së dorëzuar **nga OE Agron Commerce, konstatohet se syzet mbrojtëse të ofertuar NUK dëshmojnë përmbushjen e këtyre dy kërkesave të detyrueshme teknike.**

Konkretisht, **për syzet e ofertuar NUK është dëshmuar se lentet posedojnë trajtim anti-mjegull (anti-fog).** Në dokumentacionin teknik të paraqitur për produktin NUK rezulton karakteristika e kërkuar anti-fog, ndërsa as nga mostra e dorëzuar NUK ekziston etiketim apo dëshmi përmes së cilës mund të verifikohet se syzet e ofertuar posedojnë këtë trajtim.

Kjo nuk është një karakteristikë e parëndësishme. Autoriteti Kontraktues e ka kërkuar shprehimisht trajtimin anti-fog për të siguruar pamje të qartë gjatë përdorimit në ambiente me ndryshim temperature ose lagështi dhe, rrjedhimisht, përbën karakteristikë funksionale të produktit të kërkuar.

Gjithashtu, **mostra e syzeve të dorëzuara nga OE i propozuar për kontratë NUK është pajisur me kuti apo mbështjellës mbrojtës**, ndonëse Aneksi 1 ka kërkuar shprehimisht ruajtjen në “kuti ose mbështjellës mbrojtës për shmangien e gërvishtjeve dhe dëmtimeve.”

Pra, për të njëjtin artikull janë identifikuar së paku dy mospërputhje konkrete me Aneksin 1:

3. Mungesa/mosdëshmimi i trajtimit anti-mjegull (anti-fog);
4. Mungesa e kutisë ose mbështjellësit mbrojtës të kërkuar.

Përderisa këto karakteristika janë përcaktuar në SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, dhe oferta e OE Agron Commerce NUK i ka përmbushur me dokumentacion teknik dhe moster te cila NUK dëshmojnë përmbushjen e tyre.

Një trajtim i tillë ngre çështje serioze në raport me Nenin 7 të LPP-së – barazia në trajtim dhe mosdiskriminimi, si dhe me Nenin 59, veçanërisht paragrafin 4 të LPP-së, lidhur me ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që gjatë rishqyrtimit të bëjë riezaminimin e ofertës teknike dhe mostrës së syzeve mbrojtëse të OE Agron Commerce, dhe, në mungesë të dëshmive për përmbushjen e këtyre kërkesave, të konstatojë se artikulli i ofertuar NUK është në përputhje me Specifikimet Teknike të Detyrueshme të Aneksit 1.

Pretendimi ankimor 14

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, për artikullin “Dorëza speciale për telë gjemborë”, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht që materiali i dorezës të jetë:

“Çelik inox 316L.”

Kjo kërkesë është përcaktuar në mënyrë konkrete dhe nuk i referohet në përgjithësi vetëm materialit “çelik inox”, por një grade specifike të çelikut inox – 316L, e kërkuar për shkak të karakteristikave të tij, përfshirë rezistencën e lartë ndaj korrozionit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të dorëzuar nga OE Agron Commerce, konstatohet se për produktin e ofertuar materiali është deklaruar vetëm si:

“Stainless Steel / Çelik inox” pa u specifikuar dhe pa u dëshmuar se bëhet fjalë konkretisht për çelik inox 316L, ashtu siç është kërkuar në Aneksin 1.

Termi i përgjithshëm “çelik inox” nuk është i barasvlershëm me specifikimin “çelik inox 316L”, pasi ekzistojnë grade të ndryshme të çelikut inox me përbërje dhe karakteristika të ndryshme. Për rrjedhojë, vetëm deklarimi se produkti është prej çeliku inox nuk është dëshmi se ai është prodhuar nga grada specifike 316L e kërkuar nga AK.

Meqenese **katalogu, fleta teknike**, deklarata e prodhuesit si dhe dokumentacioni tjetër i dorëzuar me ofertën **NUK e identifikon materialin si “çelik inox 316L”, atëherë OE NUK ka dëshmuar përmbushjen e kësaj kërkesë teknike të Aneksit 1.**

Për më tepër, kjo mangësi nuk duhet të plotësohet pas afatit të ofertimit duke paraqitur një produkt tjetër apo duke ndryshuar materialin e produktit të ofertuar, pasi grada e materialit përbën një karakteristikë teknike të produktit konkret.

Nëse AK e ka konsideruar produktin në përputhje me specifikimet, kërkojmë që gjatë rishqyrtimit të identifikojë konkretisht në cilin dokument të dorëzuar me ofertën dhe në cilën faqe është dëshmuar se materiali i dorezës së ofertuar është Stainless Steel 316L.

Në mungesë të kësaj dëshmie, konsiderojmë se **OE Agron Commerce NUK ka dëshmuar përputhshmërinë e produktit të ofertuar me kërkesën e detyrueshme “Çelik inox 316L” të Aneksit 1**, dhe oferta duhet të riezaminohet në përputhje me Nenin 59 të LPP-së, duke respektuar gjithashtu parimin e trajtimit të barabartë sipas Nenit 7 të LPP-së.

Prova: Aneksi 1 i DT-së dhe dokumentacioni teknik/katalogu i OE-së së propozuar, ku materiali është deklaruar vetëm “Stainless Steel”, pa specifikimin 316L.

Pretendimi ankimor 15

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, për artikullin “Dorëza speciale për telë gjemborë”, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar karakteristika të veçanta teknike dhe mbrojtëse të produktit, duke kërkuar ndër të tjera **konstruksion me unaza prej çeliku inox të salduara individualisht, dizajn të kthyeshëm me 5 gishta**, si dhe material prej çeliku inox.

Përveç karakteristikave konstruktive, në Aneksin 1 është përcaktuar shprehimisht:

“Të gjitha produktet duhet të jenë të cilësisë së lartë dhe në përputhje të plotë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare të aplikueshme (EN ISO / CE) për pajisje personale mbrojtëse (PPE) dhe tekstile profesionale pune.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të dorëzuar nga OE AGRON COMMERCE, për dorezat speciale të ofertuar nuk është dëshmuar përputhshmëria me standardet evropiane dhe ndërkombëtare të aplikueshme për Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPE), EN ISO/CE, sipas kërkesës së Aneksit 1.

Për një produkt që ka funksion specifik mbrojtjen e përdoruesit nga prerjet dhe rreziqet mekanike, përputhshmëria me kërkesat për **PPE nuk mund të prezumohet vetëm mbi bazën e fotografisë**, përshkrimit komercial apo deklaramit të materialit të produktit.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të mundësojë verifikimin se produkti konkret i ofertuar është në përputhje me standardet dhe kërkesat e aplikueshme për PPE, ashtu siç është kërkuar shprehimisht nga AK.

Nëse **dokumentacioni i AGRON COMMERCE nuk përmban certifikatë, EU Declaration of Conformity, raport testimi apo dokument tjetër të kërkuar/lejuar nga DT që dëshmon EN/CE** për modelin konkret, atëherë NUK ekziston bazë dokumentare për konstatimin se kjo kërkesë e Aneksit 1 është përmbushur.

Pretendimi ynë kryesor është se **OE AGRON COMMERCE NUK ka dëshmuar se doreza speciale e ofertuar është në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare të aplikueshme EN ISO/CE për PPE**, megjithëse kjo është kërkuar shprehimisht në Aneksin 1.

Në mungesë të një dëshmie të tillë, konsiderojmë se oferta NUK dëshmon përputhshmëri të plotë me Specifikimet Teknike të Detyrueshme të Aneksit 1 dhe duhet të riekzaminohet në kuadër të Nenit 59 të LPP-së, duke zbatuar të njëjtin standard vlerësimi ndaj të gjithë OE-ve në pajtim me Nenin 7 të LPP-së.

Pretendimet ankimore, per – OE ARTATEX shpk

Pretendimi ankimor 16

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, për artikullin “Pantallona të Mekanikëve”, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht:

“Dendësia e materialit: 250–300 g/m², që siguron qëndrueshmëri të lartë dhe rezistencë ndaj konsumimit gjatë punës intensive.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të dorëzuar nga **OE ARTATEX SH.P.K.**, konstatohet se për **pantallonat e ofertuar është deklaruar dendësia/pesha e materialit: 230 g/m².**

Rrjedhimisht, produkti i ofertuar nga ARTATEX SH.P.K. nuk e përmbush kërkesën minimale të përcaktuar në Aneksin 1, pasi Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar interval të qartë dhe të matshëm prej 250 deri në 300 g/m², ndërsa produkti i ofertuar është 230 g/m², respektivisht 20 g/m² nën kufirin minimal të lejuar.

Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me paqartësi të dokumentacionit, interpretim subjektiv të specifikimit apo devijim të parëndësishëm, por me një **mospërputhje të drejtpërdrejtë numerike ndërmjet karakteristikës së kërkuar dhe karakteristikës së produktit të ofertuar:**

Kërkesa e DT: 250–300 g/m²
Oferta e ARTATEX SH.P.K.: 230 g/m²
Devijimi nga minimumi: –20 g/m²

Për më tepër, vetë AK në specifikimin teknik ka ndërlidhur dendësinë prej 250–300 g/m² me qëndrueshmërinë e lartë dhe rezistencën ndaj konsumimit gjatë punës intensive. Për këtë arsye, **kufiri minimal prej 250 g/m² nuk mund të konsiderohet vetëm kërkesë formale**, por është një karakteristikë teknike dhe funksionale e produktit të kërkuar.

Pranimi i një produkti me dendësi 230 g/m² do të nënkuptonte pranimin e një karakteristike teknike jashtë intervalit të përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe, në praktikë, ndryshimin e kërkesës minimale nga 250 g/m² në 230 g/m² pas afatit për dorëzimin e ofertave.

Nëse oferta e ARTATEX SH.P.K. është konsideruar e përgjegjshme pavarësisht kësaj mospërputhjeje, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka bërë vlerësimin në përputhje me Nenin 59, paragrafin 4 të LPP-së, sipas të cilit tenderi duhet të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Kjo çështje duhet të shqyrtohet gjithashtu në raport me Nenin 7 të LPP-së – trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi, veçanërisht duke marrë parasysh se oferta e PROGLOBAL SH.P.K. është eliminuar nga AK për pretendime lidhur me karakteristika teknike të mostrave që NUK qendrojnë, ndërsa një OE tjetër nuk mund të konsiderohet i përgjegjshëm kur dokumentacioni i tij teknik deklaron shprehimisht një vlerë jashtë kufijve të përcaktuar në Aneksin 1.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që gjatë rishqyrtimit të vendimit të bëjë riezaminimin e ofertës së ARTATEX SH.P.K. për artikullin “Pantallona të Mekanikëve” dhe, bazuar në dokumentacionin teknik të dorëzuar me ofertë, të konstatojë se dendësia 230 g/m² nuk përmbush kërkesën e detyrueshme 250–300 g/m² të Aneksit 1, dhe rrjedhimisht oferta NUK dëshmon përputhshmëri me këtë specifikim teknik.

Prova: Aneksi 1 i Dosjes së Tenderit dhe dokumentacioni teknik i dorëzuar nga ARTATEX SH.P.K., ku deklarohet dendësia 230 g/m².

Pretendimi ankimor 17

OE ARTATEX SH.P.K. ka ofertuar Xhakët me përbërje materiali në kundërshtim me specifikimin teknik, ndërsa në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, për artikullin “Xhakët të Mekanikëve”, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht përbërjen e materialit:

“Material i përbërë nga 65% poliestër dhe 35% pambuk.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të dorëzuar nga OE ARTATEX SH.P.K., konstatohet se produkti i ofertuar është deklaruar me përbërje:

65% poliestër dhe 35% pambuk si dhe 87% najlon dhe 13% elasthan.

Produkti i ofertuar, rrjedhimisht, nuk përputhet me përbërjen e materialit të përcaktuar në Aneksin 1.

Nuk kemi të bëjmë me një diferencë të vogël në përqindjen e të njëjtave materiale, por me materiale thelbësisht të ndryshme nga ato të kërkuara:

Kërkesa e DT: 65% poliester + 35% pambuk

Oferta e **ARTATEX SH.P.K.**: 65% poliester dhe 35% pambuk dhe 87% najlon + 13% elastan

Produkti i ofertuar nuk përmban përbërjen e kërkuar 65% poliester / 35% pambuk, por një kombinim tjetër materialesh, përkatësisht najlon/elastan.

Përderisa përbërja e materialit është përcaktuar konkretisht në Specifikimet Teknike të Detyrueshme, AK nuk mund ta konsiderojë automatikisht një përbërje tjetër si ekuivalente pa pasur bazë në Dosjen e Tenderit që lejon një devijim ose ekuivalencë të tillë.

Një **mospërputhje e tillë NUK mund të korrigjohet pas afatit përmes sqarimit** duke ndryshuar përbërjen e materialit apo duke ofertuar një model tjetër, pasi kjo do të nënkuptonte ndryshimin e produktit dhe të një karakteristike materiale të ofertës së dorëzuar. Për këtë arsye, konsiderojmë se pranimi i këtij produkti është në kundërshtim me Nenin 59, paragrafin 4 të LPP-së, lidhur me përputhshmërinë e tenderit me kërkesat e Dosjes së Tenderit, si dhe duhet të shqyrtohet në raport me Nenin 7 të LPP-së, për trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë.

Në Aneksin 1 është kërkuar:

“Dy xhepa në kraharor dhe dy xhepa anësorë funksionalë për mbajtjen e veglave dhe pajisjeve të vogla të punës.”

Ndërsa sipas dokumentacionit teknik, xhaketa e ofertuar nga ARTATEX SH.P.K. është deklaruar me 10 xhepa.

Pretendimi ankimor 18 – Maicat për mekanikë të ofruara nga ARTATEX SH.P.K. nuk dëshmojnë përmbushjen e kërkesave të detyrueshme për etiketim dhe madhësi

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar për artikujt e veshjeve, ndër të tjera, këto kërkesa:

“Të gjitha produktet duhet të përmbajnë etiketa origjinale të prodhuesit, përfshirë udhëzimet për përdorim, mirëmbajtje, kushtet e larjes dhe ruajtjes sipas standardeve të produktit.”

Gjithashtu është kërkuar:

“Të gjitha artikujt duhet të jenë të disponueshëm në madhësitë standarde: Për veshje: S, M, L, XL, 2XL, 3XL.”

Nga shqyrtimi i **dokumentacionit teknik dhe mostrës së dorëzuar nga OE ARTATEX SH.P.K. për artikullin “Maicë për Mekanikë”, konstatohet se NUK është dëshmuar përmbushja e këtyre kërkesave të detyrueshme të Aneksit 1.**

Së pari – mungesa e etiketimit dhe udhëzimeve të kërkuara. **Në mostrën dhe dokumentacionin teknik të paraqitur NUK janë dëshmuar etiketat origjinale të prodhuesit** me të gjitha informacionet e kërkuara nga DT, përkatësisht udhëzimet për përdorim, mirëmbajtje, kushtet e larjes dhe ruajtjes sipas standardeve të produktit.

Kjo kërkesë është formuluar qartë nga AK me shprehjen **“Të gjitha produktet duhet të përmbajnë”**, që nënkupton se këto elemente duhet të jenë të pranishme dhe të verifikueshme në produktin konkret të ofertuar. Përderisa mostra është dorëzuar pikërisht për verifikimin e përputhshmërisë teknike, mungesa e këtyre elementeve në mostër nuk mund të konsiderohet si çështje thjesht formale.

Së dyti – mosdëshmimi i madhësive S, M, L, XL, 2XL dhe 3XL. **Në dokumentacionin teknik të dorëzuar nga ARTATEX SH.P.K. për maicën e ofertuar nuk është dëshmuar se modeli konkret është i disponueshëm në të gjitha madhësitë e kërkuara S, M, L, XL, 2XL dhe 3XL.**

Nëse katalogu, fleta teknike apo dokumentacioni tjetër i prodhuesit nuk e paraqet këtë gamë madhësish, atëherë **NUK ekziston dëshmi** në ofertë mbi bazën e së cilës AK mund të konstatojë se produkti konkret i ofertuar përmbush këtë kërkesë të Aneksit 1.

NUK është e mjaftueshme të supozohet se një artikull tekstili mund të prodhohet apo furnizohet edhe në madhësi të tjera. Vlerësimi duhet të bëhet mbi produktin konkret të ofertuar dhe dokumentacionin e dorëzuar për të, sipas kërkesave të përcaktuara paraprakisht në DT.

Për rrjedhojë, për artikullin “**Maicë për Mekanikë**” janë identifikuar së paku **dy mangësi**:

1. Nuk është dëshmuar përmbushja e kërkesës për etiketat origjinale të prodhuesit dhe informacionet për përdorim, mirëmbajtje, larje dhe ruajtje;
2. Nuk është dëshmuar se produkti konkret i ofertuar është i disponueshëm në të gjitha madhësitë S, M, L, XL, 2XL dhe 3XL.

Pavarësisht këtyre mangësive, nëse AK do të duhej ta konsideronte ofertën e ARTATEX SH.P.K. teknikisht të papërgjegjshme, bazuar në dokumentet konkrete të ofertës dhe mostres se dorëzuar.

Pranimi i një produkti pa dëshmi të përmbushjes së kërkesave të detyrueshme të Aneksit 1 duhet të shqyrtohet në raport me Nenin 59, paragrafin 4 të LPP-së. Për karakteristika të produkteve dhe mostrave, çështja duhet të vlerësohet edhe në raport me Nenin 7 të LPP-së, përkatësisht parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Për këtë arsye kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që gjatë rishqyrtimit të bëjë riekzaminimin e dokumentacionit teknik dhe mostrës së ARTATEX SH.P.K. për artikullin “Maicë për Mekanikë” dhe, të konstatojë se produkti i ofertuar NUK dëshmon përputhshmëri me Specifikimet Teknike të Detyrueshme të Aneksit 1.

Pretendimi ankimor 19

Xhupi/Gjëmperi me zinxhir i ofertuar nga ARTATEX SH.P.K. nuk përputhet me materialin e kërkuar në Aneksin 1.

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, për artikullin “Xhup/Gjëmper me Zinxhir për Mekanik”, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar:

“Materiali: Material i përbërë nga përzierje pambuk-poliester ose 100% poliester.”

Nga dokumentacioni teknik i dorëzuar nga **OE ARTATEX SH.P.K.**, rezulton se produkti i ofertuar ka përbërjen:

94% GRS Polyester, 6% Elastane Ripstop.

Përbërja e deklaruar nga ARTATEX SH.P.K. **NUK përputhet me asnjërën prej alternativave** të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

Konkretisht:

Kërkesa e DT: përzierje pambuk–poliester, OSE 100% poliester.

Produkti i ARTATEX SH.P.K.: 94% poliester + 6% elasthan.

Produkti i ofertuar **NUK është përzierje pambuk–poliester, pasi nuk përmban pambuk**, dhe njëkohësisht **NUK është 100% poliester, pasi 6% e përbërjes së tij është elasthan.**

Rrjedhimisht, kemi një mospërputhje të drejtpërdrejtë, objektive dhe të verifikueshme nga vetë dokumentacioni teknik i OE-së. Nuk bëhet fjalë për interpretim subjektiv të mostrës, por për përbërjen e deklaruar nga vetë prodhuesi/operatori ekonomik.

Fakti që materiali është deklaruar si GRS Polyester apo se ka konstruksion Ripstop nuk e ndryshon përqindjen e përbërjes së produktit dhe nuk e bën atë 100% poliester. Përmbajtja prej 6% elastan e vendos produktin jashtë dy alternativave të lejuara nga DT.

Nëse AK NUK ka pasur baze që të konsiderojë përbërjen 94% poliester / 6% elastan si përzierje pambuk-poliester ose si 100% poliester, kur dokumentacioni teknik i dorëzuar nga ARTATEX SH.P.K. dëshmon të kundërtën.

Kërkesa për 2 xhepa anësorë për Xhupin/Gjëmpërin me zinxhir

Në Aneksin 1 është kërkuar gjithashtu që artikulli të ketë:

“2 xhepa anësorë.”

Ndërsa në dokumentacionin teknik të ARTATEX SH.P.K. produkti paraqitet si xhup me 10 xhepa.

Nëse dokumentacioni teknik i ARTATEX SH.P.K. vetëm deklaron “10 pockets”, pa dëshmuar se produkti posedon konkretisht 2 xhepa anësorë, atëherë vetëm numri total i xhepave nuk është dëshmi e mjaftueshme për përmbushjen e specifikimit të DT-së.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që gjatë rishqyrtimit të bëjë riezaminimin e ofertës së ARTATEX SH.P.K. për artikullin “Xhup/Gjëmpër me Zinxhir për Mekanik” dhe të konstatojë se përbërja 94% GRS Polyester / 6% Elastane Ripstop NUK përmbush kërkesën e detyrueshme të Aneksit 1, duke e trajtuar ofertën në përputhje me Nenin 59 të LPP-së dhe duke zbatuar të njëjtin standard vlerësimi ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë sipas Nenit 7 të LPP-së.

Pretendimi ankimor 20

Syzet mbrojtëse të ofruara **NUK i përmbushin kërkesat e detyrueshme për trajtim anti-fog dhe ruajtje mbrojtëse**

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, për artikullin “Syze Mbrojtëse për Mekanik”, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar ndër të tjera këto kërkesa:

“Trajtim anti-mjegull (anti-fog) për pamje të qartë gjatë përdorimit në ambiente me ndryshim temperature ose lagështi.”

dhe

“Ruajtje në kuti ose mbështjellës mbrojtës për shmangien e gërvishtjeve dhe dëmtimeve.”

Nga shqyrtimi i ofertës teknike dhe mostrës së dorëzuar nga OE Artatex, konstatohet se syzet mbrojtëse të ofertuar **NUK** dëshmojnë përmbushjen e këtyre dy kërkesave të detyrueshme teknike.

Konkretisht, për syzet e ofertuar **NUK është dëshmuar se lentet posedojnë trajtim anti-mjegull (anti-fog)**. Në dokumentacionin teknik të paraqitur për produktin nuk rezulton karakteristika e kërkuar anti-fog, ndërsa as nga mostra e dorëzuar nuk ekziston etiketim apo dëshmi përmes së cilës mund të verifikohet se syzet e ofertuar posedojnë këtë trajtim.

Kjo nuk është një karakteristikë e parëndësishme. Autoriteti Kontraktues e ka kërkuar shprehimisht trajtimin anti-fog për të siguruar pamje të qartë gjatë përdorimit në ambiente me ndryshim temperature ose lagështi dhe, rrjedhimisht, përbën karakteristikë funksionale të produktit të kërkuar.

Gjithashtu, mostra e syzeve të dorëzuara nga OE i propozuar për kontratë **NUK është pajisur me kuti apo mbështjellës mbrojtës**, ndonëse Aneksi 1 ka kërkuar shprehimisht ruajtjen në “kuti ose mbështjellës mbrojtës për shmangien e gërvishtjeve dhe dëmtimeve.”

Pra, për të njëjtin artikull janë identifikuar së paku **dy mospërputhje konkrete** me Aneksin 1:

5. Mungesa/mosdëshmimi i trajtimit anti-mjegull (anti-fog);
6. Mungesa e kutisë ose mbështjellësit mbrojtës të kërkuar.

AK e ka konsideruar për këtë artikull subjektivisht ka konstatuar se syzet posedojnë trajtim anti-fog dhe ku është konstatuar ekzistenca e kutisë ose mbështjellësit mbrojtës, kur këto elemente **NUK** rezultojnë nga oferta/mostra e dorëzuar.

Një trajtim i tillë ngre çështje serioze në raport me Nenin 7 të LPP-së – barazia në trajtim dhe mosdiskriminimi, si dhe me Nenin 59, veçanërisht paragrafin 4 të LPP-së, lidhur me ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve dhe përputhshmërinë e tyre me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që gjatë rishqyrtimit të vendimit të bëjë riezaminimin e ofertës teknike dhe mostrës së syzeve mbrojtëse të OE në mungesë të dëshmive për përmbushjen e këtyre kërkesave, të konstatojë se artikulli i ofertuar **NUK** është në përputhje me Specifikimet Teknike të Detyrueshme të Aneksit 1.

Pretendimi ankimor 21

Mungesa e certifikimit të kërkuar EN ISO / CE për artikujt e veshjeve, në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar si kërkesë për artikujt e veshjeve:

“Certifikim përputhshmërie me standardet relevante EN ISO / CE për veshje pune profesionale.”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së OE Artatex, konstatohet se për artikujt e veshjeve pjesë e ofertës **NUK janë dorëzuar certifikatat/dokumentet e përputhshmërisë EN ISO / CE të kërkuara në Aneksin 1.**

Kërkesa për certifikim është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në kuadër të Specifikimeve Teknike të Detyrueshme dhe për këtë arsye përmbushja e saj duhet të verifikohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Në mungesë të dokumentacionit të kërkuar të përputhshmërisë, **NUK** mund të konsiderohet e dëshmuar se artikujt e veshjeve të ofertuar nga OE Artatex janë në përputhje me standardet relevante EN ISO dhe kërkesat CE të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar shprehimisht certifikim të përputhshmërisë.

Për rrjedhojë, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që gjatë rishqyrtimit të vendimit të verifikojë për secilin artikull të veshjeve në ofertën e OE Artatex ekzistencën e dokumentacionit të kërkuar EN ISO / CE dhe, meqenese dokumentacioni **NUK** është dorëzuar sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, të konstatojë se oferta **NUK** i përmbush kërkesat e detyrueshme teknike të Aneksit 1 dhe të ndërmarrë veprimet përkatëse në përputhje me dispozitat e prokurimit publik.

Pretendimi ankimor 22

“Dorëza speciale për telë gjemborë” e ARTATEX SH.P.K. nuk përmbush specifikimet e detyrueshme, në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, për artikullin “Dorëza speciale për telë gjemborë”, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar karakteristika të qarta teknike dhe konstruktive të produktit, përfshirë dizajnin me 5 gishta, konstruksionin me unaza prej çeliku inox dhe unazën prej çeliku inox të salduar për shtrëngim në kyçin e dorës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik dhe produktit të ofertuar nga OE ARTATEX SH.P.K., **konstatohet se oferta NUK dëshmon përmbushjen e plotë të këtyre kërkesave.**

Së pari, **dokumentacioni teknik i paraqitur është kontradiktor, pasi fotografia paraqet një dorezë me 5 gishta, ndërsa përshkrimi teknik në katalog i referohet një doreze me 3 gishta.** Kjo krijon paqartësi të drejtpërdrejtë lidhur me modelin konkret që është ofertuar dhe karakteristikat reale të tij.

Së dyti, nga dokumentacioni/fotografia e produktit të ofertuar rezulton se **doreza NUK posedon unazën prej çeliku inox të salduar për shtrëngim në kyçin e dorës**, ndonëse kjo karakteristikë është kërkuar shprehimisht në Aneksin 1 të DT-së.

Mungesa e kësaj unaze për produktin paraqet mospërputhje konstruktive dhe funksionale me produktin e specifikuar nga AK. Mekanizmi i kërkuar për shtrëngim në kyç është pjesë e konfigurimit teknik të dorezës dhe nuk mund të konsiderohet i përmbushur nga një produkt që nuk e posedon fare këtë element.

Së treti, **dokumentacioni i dorëzuar ngre dyshime të arsyeshme lidhur me autenticitetin dhe saktësinë e katalogut, për shkak se fotografia dhe përshkrimi teknik nuk korrespondojnë mes tyre.** Për këtë arsye kërkojmë që AK të verifikojë dokumentacionin origjinal të prodhuesit, modelin dhe kodin konkret të produktit, në vend që të mbështetet vetëm në dokumentin e paraqitur nga OE.

Pra, për këtë artikull evidentohen së paku këto mospërputhje:

1. DT kërkon dizajn të kthyeshëm me 5 gishta, ndërsa përshkrimi në dokumentacionin e ARTATEX i referohet dorezës me 3 gishta, pavarësisht se fotografia paraqet produkt tjetër me 5 gishta;
2. Mungon unaza prej çeliku inox e salduar për shtrëngim në kyçin e dorës, e kërkuar në specifikimin teknik;
3. Dokumentacioni teknik është i brendshëm kontradiktor dhe nuk mundëson identifikimin e sigurt të modelit dhe karakteristikave të produktit konkret të ofertuar.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se ARTATEX SH.P.K. NUK ka dëshmuar përputhshmërinë e produktit të ofertuar me kërkesat e detyrueshme të Aneksit 1.

Në mungesë të kësaj dëshmie, kërkojmë që gjatë rishqyrtimit AK të konstatojë mospërputhjen e ofertës së ARTATEX SH.P.K. me Aneksin 1 dhe ta trajtojë atë në përputhje me Nenin 59 të LPP-së, duke zbatuar të njëjtin standard të vlerësimit teknik në pajtim edhe me parimin e trajtimit të barabartë sipas Nenit 7 të LPP-së.

Pretendimi ankimor 23

Në Aneksin 1 – SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së Tenderit, për artikullin “Dorëza speciale për telë gjemborë”, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht që materiali i dorezës të jetë:

“Çelik inox 316L.”

Kjo kërkesë është përcaktuar në mënyrë konkrete dhe nuk i referohet në përgjithësi vetëm materialit “çelik inox”, por një grade specifike të çelikut inox – 316L, e kërkuar për shkak të karakteristikave të tij, përfshirë rezistencën e lartë ndaj korrozionit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të dorëzuar nga OE Artatex, konstatohet se për produktin e ofertuar materiali është deklaruar vetëm si:

“Stainless Steel / Çelik inox”

pa u specifikuar dhe pa u dëshmuar se bëhet fjalë konkretisht për çelik inox 316L, ashtu siç është kërkuar në Aneksin 1.

Termi i përgjithshëm “çelik inox” NUK është i barasvlershëm me specifikimin “çelik inox 316L”, pasi ekzistojnë grade të ndryshme të çelikut inox me përbërje dhe karakteristika të ndryshme. Për rrjedhojë, vetëm deklarimi se produkti është prej çeliku inox NUK është dëshmi se ai është prodhuar nga grada specifike 316L e kërkuar nga AK.

Nëse katalogu, fleta teknike, deklarata e prodhuesit apo dokumentacioni tjetër i dorëzuar me ofertën nuk e identifikon materialin si 316L, atëherë OE NUK ka dëshmuar përmbushjen e kësaj kërkesë teknike të Aneksit 1.

Nëse AK e ka konsideruar produktin në përputhje me specifikimet, kërkojmë që gjatë rishqyrtimit të identifikojë konkretisht në cilin dokument të dorëzuar me ofertën dhe në cilën faqe është dëshmuar se materiali i dorezës së ofertuar është Stainless Steel 316L, dhe jo vetëm “Stainless Steel”.

Në mungesë të kësaj dëshmie, konsiderojmë se **OE NUK ka dëshmuar përputhshmërinë e produktit të ofertuar me kërkesën e detyrueshme “Çelik inox 316L” të Aneksit 1**, dhe oferta duhet të riekzaminohet në përputhje me Nenin 59 të LPP-së, duke respektuar gjithashtu parimin e trajtimit të barabartë sipas Nenit 7 të LPP-së.

Prova: Aneksi 1 i DT-së dhe dokumentacioni teknik/katalogu i OE-së së propozuar, ku materiali është deklaruar vetëm “Stainless Steel”, pa specifikimin 316L.

Si perfundim kompania jonë kërkon fillimisht nga ksperti shqyrtues i OSHP-së që në kuptim të neneve 113 dhe 114 të LPP-së, të konstatojë se kompania jone PROGLOBAL SH.P.K. është e vetmja e përgjegjeshme në këtë procedurë të prokurimit në atë mënyrë që paneli shqyrtues të nxjerri këtë:

VENDIM

- I. Te Anullohet**, vendimi i AK-së i datës 07.09.2026, i i kunderligjeshëm dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim
- II. Te urdhërhjet** AK-ja që të shpërblejë me kontratë OE "Proglobal SH.P.K." si i vetmi OE i përgjegjshëm në këtë proces prokurimi dhe
- III. Te lejohe**t, kthimi i mjeteve të deponuara në emer të ankese.

Mbi këto baza, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit trajtim objektiv, profesional dhe të drejtë të kësaj çështjeje, duke vendosur ligjshmërinë e plotë në këtë aktivitet prokurimi në përputhje me dispozitat e LPP-së, në të kundërtën, nëse këto shkelje substanciale procedurale dhe materiale nuk sanksionohen brenda këtij organi ligjor, OE ankues do të detyrohet të ndjekë të gjitha rrugët e tjera ligjore dhe të iniciojë procedurat përkatëse pranë organeve gjyqësore dhe institucioneve kompetente të drejtësisë për mbrojtjen e të drejtave të veta dhe adresimin e përgjegjësisë ligjore për veprime kundërligjore.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme por deri me tani te pa kalkuluara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*